

VENDIM
Nr.261, datë 3.10.2011

MBI PAVLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO ABC”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira	Bushati	kryetare
Sami	Nezaj	zëvendëskryetar
Suela	Musta	anëtare
Alban	Karapici	anëtar
Gent	Ibrahimi	anëtar
Zylyftar	Bregu	anëtar,

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi pavlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio ABC”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 25 dhe neni 33 pikat 1 dhe 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VËREN SE:

KKRT-ja ka licencuar personin privat fizik z.Armand Baze, për subjektin radiofonik privat vendor “Radio ABC”. Me vendimin nr.700, datë 16.7.2008, KKRT-ja ka rinovuar licencën për këtë subjekt. Në përfundim të afatit të licencimit, KKRT-ja ka njoftuar subjektin për përfundimin e saj duke i kërkuar depozitimin e dokumentacionit për rinovimin e saj. Meqenëse subjekti nuk kishte shfaqur interes, KKRT-ja, në mbledhjen e datës 28.3.2011, ra dakord që subjekti të njoftohet dhe t’i lihet përsëri në dispozicion një afat i ri 30-ditor për të depozituar kërkesën së bashku me dokumentacionin për rinovimin e licencës.

Pavarësisht njoftimit të dytë, nr.569 prot., datë 4.4.2011, rezulton se deri më tani, ky subjekt nuk ka paraqitur kërkesë apo aplikim për rinovimin e saj.

KKRT-ja konstaton se afati i vlefshmërisë së licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio ABC” ka përfunduar në datën 3.1.2010.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 25 dhe nenit 33 pikat 1 dhe 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën me nr.019/FML, të subjektit radiofonik privat vendor “Radio ABC”.
 2. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati